

Hendeku në mes institucioneve dhe qytetarëve në Komunën e **Obiliqit**

—
Maj 2018



Hyrje

Një ndër sfidat më të mëdha të demokracisë përfaqësuese në Kosovë mbetet hendeku i madh që ekziston mes përfaqësuesve dhe të përfaqësuarve. Për këtë fajet janë të dyanshme: e para, institucionet nuk ndërmarrin masa të mjaftueshme për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje; e dyta, qytetarët nuk shprehen mjaft të interesuar për të marrë pjesë në vendimet të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

Qasja e institucioneve dhe sjellja e qytetarëve ndikojnë njëra tjetrën: nëse institucionet injorojnë sugjerimet e qytetarëve, ndikojnë në demotivimin e mëtejshëm të qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje; dhe anasjelltas, insistimi i qytetarëve për të hapur debat dhe kontribuar në vendimmarrje ndikon në ndryshimin e qasjes së institucioneve duke i bërë ato më të përgjegjshme.

Andaj, përfaqësuesit institucional dhe qytetarët duhet të bëjnë më shumë në zvogëlimin dhe eliminimin e hendekut në komunikim mes tyre. Mediat dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë lehtësues të komunikimit mes institucioneve dhe qytetarëve. Në funksion të kësaj, Instituti GAP ka kryer një hulumtim në tri komuna të Kosovës, Kamenicë, Han të Elezit dhe Obiliq, për të matur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, pengesat në pjesëmarrje, qasjen e institucioneve komunale, mënyrën e informimit.

Ky raport përmban rezultatet e anketës së zhvilluar me qytetarët e Komunës së Obiliqit. Në fillim të muajit prill, Instituti GAP përmes kompanisë profesionale të anketimit, ka pyetur 157 qytetarë të Komunës së Obiliqit për atë se sa janë të informuar me punën e komunës dhe pjesëmarrjen e tyre në diskutimet që i organizon komuna dhe bashkësia lokale.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të ndahen me përfaqësuesit politik dhe zyrtarët për informim në Komunën e Obiliqit, me qëllim të përmirësimit të komunikimit me qytetarë, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe zvogëlimin e hendekut në mes të përfaqësuesve dhe të përfaqësuarve.

Parimet dhe baza ligjore për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje

Një ndër parimet bazë të sistemeve demokratike është edhe qeverisja transparente, llogaridhënëse dhe angazhimi i qytetarëve në të gjitha fazat e procesit të vendimmarrjes. Këto parime të demokracisë janë mirë të përfshira edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sipas Kushtetutës, institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.¹ Po ashtu, Komunitatet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.²

Ligji për vetëqeverisje lokale³ garanton pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivel të komunës. Sipas këtij ligji, çdo komunë është e obliguar që të mbajë së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45, pika 3.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 124, pika 1.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale. Burimi: <http://bit.ly/1CulaKA>


Ligji për vetëqeverisje lokale obligon komunat që të nxjerrin rregullore komunale për transparencë. Pjesa më e madhe e komunave kanë nxjerrë rregulloret për transparencë. Thua se të gjitha rregulloret komunale për transparencë ngjasojnë në përpikëri njëra me tjetrën. Kuvendi Komunal i Obiliqit ka aprovuar Rregulloren për transparencë me 2013.⁴ Komuna e Obiliqit është një ndër komunat e pakta që nuk e ka të publikuar Rregulloren për transparencë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rezultatet e anketës me qytetarë për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në Komunën e Hanit të Elezit

Më muajin prill të vitit 2018, Instituti GAP ka angazhuar një kompani profesionale të hulumtimeve për të mat qëndrimet e qytetarëve rreth pjesëmarrjes së tyre në procesin e vendimmarrjes. Hulumtimi është kryer në tri komuna të Kosovës: Kamenicë, Obiliq dhe Han të Elezit. Në Komunën e Obiliqit janë anketuar 157 qytetarë në lokalitete të ndryshme.

Në pyetjen se sa mendoni që jeni të informuar me punën dhe aktivitetet e komunës suaj, vetëm 10% e qytetarëve janë deklaruar se janë shumë të informuar, kurse 25% kanë deklaruar se nuk janë aq të informuar e pothuajse 22% aspak të informuar.


Fig. 1: Sa vlerësoni se jeni të informuar për punët dhe aktivitetet që bënë komuna e juaj?



Në pyetjen se prej nga informohen qytetarët për aktivitetet e institucioneve komunale, burimi më i rëndësishëm i informimit janë mediat elektronike, miqtë apo të afërmit dhe rrjetet sociale. Nga të gjitha burimet e informimit, më së paku qytetarët informohen nga faqja zyrtare e komunës në internet.

⁴ Komuna e Obiliqit. Rregullore për transparencë. Burimi: <https://bit.ly/2MEgkxj>

Fig. 2: Prej nga informoheni për aktivitetet e Komunës tuaj?*



* Pyetje me më shumë se një përgjigje

Një numër i vogël i respondentëve kanë deklaruar se marrin pjesë në takimet që organizon Komuna, kurse 77% e qytetarëve deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në takimet që ka organizuar Komuna. Nga ata që kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga Komuna, pjesa më e madhe janë informuar nga miqtë apo të afërmit ose thirrjet e vendosura në lagje dhe rrjetet sociale, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve kanë kuptuar për takimet e komunës nga uebfaqja e komunës (8%) (figura 4).

Fig. 3: A keni marr pjesë në ndonjë takim/diskutim publik të organizuar nga Komuna?






Fig. 4: Nga jeni informuar në lidhje me atë takim?




Nga ata që e vizitojnë uebfaqen e Komunës në internet, vetëm 9% e të anketuarve e vizitojnë atë çdo ditë, kurse një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve e vizitojnë atë disa herë në javë (28%) apo disa herë në muaj (nga 25%), ndërsa 19% e të anketuarve e vizitojnë uebfaqen e komunës shumë rrallë.

Fig.5: Sa shpesh i qaseni faqes së Komunës në internet?




Shumica e atyre që i qasni faqes së Komunës në internet, i qasni për tu informuar për konkurset e punës (46%). Pastaj arsye të tjera janë për të kuptuar më shumë për planin e investimeve (16%), njoftimet për prokurim (12%) dhe thirrjet për propozim (11%), ndërsa më së paku i qasni për të parë raportin vjetor financiar (4%).

Fig. 6: Zakonisht për çfarë arsye i qasni faqes zyrtare të Komunës në internet?




Pothuajse gjysma e qytetarëve të anketuar (42%) nuk janë në dijeni se u garantohej e drejta për qasje në dokumente zyrtare.

Fig. 7: A jeni në dijeni për të drejtat që keni për qasje në dokumentet publike të komunës?




Në rast se ftohen nga Komuna për të marrë pjesë në diskutimet për investimet në komunë, 88% e të anketuarve shprehen se do të merrnin pjesë.

Fig.8: Nëse ftoheni nga komuna për të diskutuar në lidhje me planet për investime në projekte, a do të merrnit pjesë?



Sa i përket mënyrës së informimit, qytetarët preferojnë që të njoftohen përmes thirrjeve telefonike (28%), ftesës së dërguar në shtëpi (25%), mesazheve telefonike (22%), njoftimit në rrjete sociale (12%) dhe përmes mediave (7%).


Fig.9: Si do të dëshironit të informoheshin për takimet që organizon komuna?



Qytetarët e anketuar të cilët kanë deklaruar se në pesë vitet e fundit komuna ka investuar në lagjen e tyre, vetëm 14% janë deklaruar se janë konsultuar në të gjitha rastet, 19% e të anketuarve janë deklaruar se komuna i ka konsultuar shpesh, kurse një pjesë e konsiderueshme shprehen se komuna i ka konsultuar vetëm në disa raste (44%), apo se nuk janë konsultuar asnjëherë (9%).

Në rast se Komuna u kërkon qytetarëve të shprehin kërkesat e tyre apo të japin sugjerime me shkrim, 46% e të anketuarve shprehen se do t'i përgjigjeshin pozitivisht një thirrjeje të tillë.

Fig.10: Në rast që komuna do të kërkonte mendimet/komentet e juaja me shkrim në lidhje me disa çështje publike a do t'i dërgonit ato?




Në diskutimet publike që organizohen nga Komuna, pjesa dërrmuese e qytetarëve të anketuar (70%) preferojnë që në ato takime të jetë prezent edhe Kryetari i Komunës, kurse një pjesë tejet e vogël e të anketuarve nuk e konsiderojnë pjesëmarrjen e Kryetarit në këto diskutime aq apo fare të rëndësishme (nga 2%).

Përkundër asaj se anëtarët e Kuvendit Komunal zgjidhen me votat e qytetarëve, pas marrjes së mandatit ekziston ndërveprim shumë i ulët në mes të të zgjedhurve dhe zgjedhësve. Të pyetur se a janë takuar zyrtarisht me ndonjërin nga anëtarët e Kuvendit Komunal në 12 muajt e fundit, 69% e qytetarëve janë përgjigjur me jo, kurse 31% e qytetarëve kanë pasur takim së paku një herë.

Këshillat lokal janë organizime në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, të cilat funksionojnë në kuadër të lagjeve urbane dhe fshatrave. Qëllimi i këshillave lokal është mbajtja e kontakteve me qytetarët e lokaliteteve të ndryshme dhe adresimi i kërkesave dhe sugjerimeve të banorëve të lokaliteteve tek organet vendimmarrëse të komunës.

Pjesë e konsiderueshme e qytetarëve të anketuar (27%) deklarojnë se këshilli lokal në vendbanimin e tyre është funksional, ndërsa 60% e të anketuarve deklarojnë se këshilli nuk funksionon, 9% nuk kanë informacion për punën e këshillave lokale, e 4% deklarojnë se nuk ka këshill lokal ku ata jetojnë.

Fig.11: A funksionon këshilli lokal në zonën ku banoni ju?




Por, 69% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë fare kontakt me këshillat lokale, kurse 31% kanë deklaruar se kanë kontakte me udhëheqësit e këshillave lokale. Pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar (77%) preferojnë që këshillat lokale të luajnë edhe rolin e informimit për aktivitetet e komunës në zonën ku ata banojnë, 11% nuk e konsiderojnë këtë si të domosdoshme, kurse 12% nuk kanë ndonjë preferencë.

Në pyetjen nëse në dy vitet e fundit kanë qenë të ftuar për ndonjë takim nga këshilli lokal, 85% e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë marrë ndonjë ftesë të tillë, 12% janë shprehur se kanë marrë ftesë, kurse 3% nuk mund të konfirmojnë nëse kanë marrë ftesë ose jo. Por, pjesa më e madhe e të anketuarve (85%) kanë deklaruar se do t'i përgjigjeshin pozitivisht një ftese të tillë, kurse 10% do ta refuzonin atë.


Arsyet për refuzim të pjesëmarrjes kanë të bëjnë me mosbesimin se diçka mund të arrihet nga pjesëmarrja dhe në masë më të vogël për arsye se këta këshilla udhëhiqen nga persona jo profesionistë.

Fig. 12: Përse nuk do të merrnit pjesë në takimet e ftuara nga këshilli lokal?




Më shumë se gjysma e qytetarëve pajtohen se komuna është e përkushtuar që të përfshijë qytetarët në vendimmarrje.

Fig. 13: Sa pajtoheni me konstatimin se “Komuna është e përkushtuar që të përfshijë qytetarët në vendimarrje?”



Por njëkohësisht besojnë se Komuna angazhohet për përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje më shumë për shkak se e ka obligim ligjor, e jo për shkak se njëmend beson në kontributin që qytetarët mund të japin në konsultime.

Fig. 14: Sa pajtoheni me konstatimin se “Konsultimet e komunës me qytetarët bëhen më shumë për të përmbushur një obligim ligjor se sa që të kërkohet opinioni i qytetarëve?”



Nevoja për një strategji komunale për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje

Rezultatet e anketës tregojnë për një distancë të madhe në komunikim në mes të përfaqësuesve komunalë dhe qytetarëve. Mënyrat dhe kanalet me të cilat preferojnë të informohen qytetarët janë të ndryshme nga ato që praktikon Komuna për informim. Rregullorja për transparencë e Komunës së Obiliqit nuk përmban format e informimit.

Uebfaqja zyrtare e komunës së Obiliqit nuk jep informacione nëse kjo komuna ka të hapur ndonjë kanal zyrtar në mediat sociale. Po ashtu, nuk ka një faqe zyrtare të Komunës në facebook apo rrjete tjera sociale. Janë rreth 5600 përdorues të facebook të cilët janë nga Komuna e Obiliqit (nga moshë 13 vjeç e sipër)⁵ të cilët do të mund të targetoheshin me informacione për komunën.

Andaj, me qëllim të rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, Komuna e Obiliqit duhet të aprovoj një dokument të ri strategjik, i cili do të ishte dokument më gjithëpërfshirës se sa Rregullorja për transparencë. Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Kuvendin Komunal duhet të themeloj një grup punues në përbërje të përfaqësuesve nga Zyra e Kryetarit, Zyra për Informim, Kuvendi i Komunës, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat lokale, të cilët hartojnë një dokument të ri strategjik për informim. Një dokument i tillë duhet të përmbaj objektiva, si:

1. Rritja e transparencës komunale;
2. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
3. Fuqizimi i këshillave lokale si trupa ndërmjetësues në mes banorëve dhe institucioneve të komunës.

Për të arritur këto objektiva, strategjia e komunës për informim duhet të përfshij këto aktivitete:

- Rritja e prezencës në mediat sociale dhe rritja e ndjekësve në kanalet zyrtare të komunës më rrjetet sociale;
- Grumbullimi i të dhënave për numrat e telefonit të të gjithë atyre të cilët shprehin interesim që të informohen përmes mesazheve telefonike. Një shërbim i tillë mund të bëhet pa shpenzime nga komuna përmes përdorimit të aplikacioneve mobile;
- Të themelohen të gjitha këshillat lokale, të cilat përmes takimeve të rregullta shërbejnë edhe si kanale të informimit për qytetarët;
- Të ketë një plan vjetor të takimeve të institucioneve të komunës në qytet dhe fshatra;
- Uebfaqja e komunës të përmbaj të gjitha dokumentet publike, si vendimet e ekzekutivit dhe Kuvendit Komunal, procesverbalet e takimeve, raportet e detajuara buxhetore, konkurset, raportet e auditimit dhe njoftimet e prokurimit publik. Uebfaqja të promovohet përmes mediave sociale.
- Komuna në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat duhet të shoh mundësin e një fushate sensibilizimi në lidhje me të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike.

⁵ Burimi: Hallakate.com

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

